


# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E LIPJANIT - 2025





# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E LIPJANIT- 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,  
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

049 714 024

Qershor, 2026

## Përmbajtja:

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT .....	5
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor .....	5
Korniza ligjore.....	6
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.....	6
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor .....	7
Menaxhimi i mbeturinave .....	8
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave.....	9
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike .....	9
Licencimi dhe lejet mjedisore .....	11
PËRFUNDIME .....	13
REKOMANDIMET .....	14
Për EC:.....	15

## HYRJE

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionale në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe praktikat institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje evidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

## GJETJET E RAPORTIT

### Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Lipjanit, përgjegjësitë për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë të organizuara në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në kuadër të kësaj drejtorie funksionojnë strukturat përkatëse që trajtojnë çështjet mjedisore në nivel komunal.

Organi komunal	A është themeluar	Emri zyrtar	Fuqia punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit	/
Spektori	Po	/	/
Zyrtarë mjedisor	Po	Zyrtarë për Mbrojtjen e Mjedisit	1
Drejtoria	Po	Drejtoria e Inspektorateve	5
Spektori	Po	Mjedisit	/
Zyrtarë mjedisor	Po	Inspektor i mjedisit	1

Tabela 1. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, evidentohet mungesë e stafit të dedikuar për çështje mjedisore.

Numri i shërbyesve civil nuk vlerësohet i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, megjithatë stafi posedon profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e këtyre detyrave.

Në aspektin e përgatitjes profesionale, stafi vlerësohet në nivel të mirë (4/5).

Sa i përket trajnimeve, nuk janë raportuar trajnime të organizuara nga niveli qendror apo organizata të tjera.

Komuna shfrytëzon ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi si bazë për menaxhimin e çështjeve mjedisore.

### Korniza ligjore

Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në ushtrimin e përgjegjësisë së saj në fushën e

mjedisit mbështetet në një sërë ligjesh dhe dokumentesh ligjore sektoriale.

Ligjet dhe dokumentet kryesore të përdorura për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- Udhëzimi Administrativ për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale
- Harta Zonale Komunale
- Ligje dhe udhëzime të tjera që kanë lidhshmëri me fushën mjedisore

Korniza ligjore mjedisore vlerësohet si pjesërisht e konsoliduar.

Në aspektin e njohurive të stafit për kornizën ligjore, ato vlerësohen në nivel të mirë (4/5).

**Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**

Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë aktivitete dhe masa për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga korniza ligjore në fuqi.

Sipas të dhënave të siguruara, nuk janë raportuar dokumente specifike të planifikimit mjedisor.

Strategjitë mjedisore lokale janë të harmonizuara me strategjitë e nivelit qendror.

Sa i përket zhvillimit të projekteve mjedisore, komuna realizon aktivitete që lidhen me përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Projektet dhe aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Projekte të ndryshme mjedisore
- Mbjellje të drunjve
- Pastrimi i hapësirave të ndryshme publike

Në aspektin e masave për mbrojtjen e mjedisit, komuna ndërmerr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë dhënien e lejeve mjedisore dhe kontrollin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në mjedis.

Masat për mbrojtjen e mjedisit janë të integruara brenda aktiviteteve dhe projekteve komunale.

### **Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor**

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Lipjanit realizohet në nivel komunal përmes Drejtorisë së Inspektoratit.

Sa i përket raportimit të inspektimeve, hartohen raporte për aktivitetet inspektive.

Treguesi	Vlera
Numri i inspektimeve	397
Inspektime me procesverbal	105
Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së	2
Kontrolla për LMK	41
Të pa inspektuara LMK për vitin 2025	5
Vërejtje, njoftime	11
Punë me palë, ankesa , kërkesa	85
Lendet e pranuar dhe të shqyrtuara	73
Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	2
Gjoha mandatore	6
Aktvendime, ndalesa, urdhëresa	26
Inspektim me polici	15

*Tabela 2. Aktivitetet inspektive në fushën e ambientit - 2025*

Një nga rastet e raportuara përfshin inspektimin e një qendre grumbulluese të gomave të automjeteve jashtë përdorimit, ku është konstatuar mungesë e lejes mjedisore dhe është kërkuar iniciimi i procedurave përkatëse, ndërsa rasti është raportuar edhe në nivel qendror.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike. Po ashtu monitorohet edhe gjendja e zonave të mbrojtura.

Janë identifikuar raste të çrregullimeve mjedisore, përfshirë zonën e mbrojtur të zogjve “Ligatina e Hencit”, për të cilën është kërkuar ndërhyrje nga niveli qendror.

Sa i përket tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore, nuk janë raportuar raste.

### Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Lipjanit përbën një komponent të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor në nivel lokal. Vlerësimi i gjendjes mbështetet në të dhënat e raportuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024.

Sipas të dhënave, në vitin 2023 numri i banorëve të shërbyer në Komunën e Lipjanit ka qenë 52,625, ndërsa në vitin 2024 ky numër është raportuar 33,643 banorë, duke reflektuar një rënie prej 18,982 banorësh.<sup>1</sup>

Sa i përket sasisë së mbeturinave, gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej 13,213 ton mbeturina komunale, ndërsa në vitin 2024 kjo sasi ka qenë 13,216 ton, duke reflektuar një ndryshim minimal prej 3 tonësh.<sup>2</sup>

Në aspektin e gjenerimit të mbeturinave për banor, në vitin 2023 është raportuar 251.08 kg/banor/vit, ndërsa në vitin 2024 ky tregues ka arritur në 392.83 kg/banor/vit, që paraqet një rritje të konsiderueshme.<sup>3</sup>

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Numri i banorëve të shërbyer	52,625	33,643	-18,982
Sasia e mbeturinave (ton/vit)	13,213	13,216	+3
Sasia e mbeturinave (kg/vit)	13,213,000	13,216,000	+3,000
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	251.08	392.83	+141.75
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/ditë)	0.69	1.08	+0.39
Shkalla e mbulimit me shërbim (%)	91.4%	61.1%	-30%

Tabela 3. Statistikat kryesore për menaxhimin e mbeturinave - Komuna e Lipjanit

<sup>1</sup> Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Po aty

Të dhënat tregojnë se sasia e mbeturinave të grumbulluara në Komunën e Lipjanit ka mbetur pothuajse e njëjtë ndërmjet viteve 2023 dhe 2024, me një rritje shumë të vogël.

Megjithatë, në të njëjtën periudhë evidentohet një rënie e konsiderueshme në numrin e banorëve të shërbyer, çka ndikon drejtpërdrejt në rritjen e treguesit të gjenerimit të mbeturinave për banor.

Në këtë kontekst, rritja e dukshme e gjenerimit të mbeturinave për banor nuk duhet të interpretohet si rritje reale e prodhimit të mbeturinave, por si rezultat i ndryshimeve në bazën e të dhënave dhe metodologjinë e raportimit ndërmjet viteve.

Në përgjithësi, të dhënat theksojnë nevojën për përmirësim të sistemit të menaxhimit të të dhënave dhe harmonizim të metodologjisë së raportimit, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë më e saktë e gjendjes së menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal.

### **Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave**

Komuna e Lipjanit nuk ka sistem funksional të monitorimit të komponentëve kryesorë mjedisorë.

Sa i përket monitorimit të cilësisë së ajrit, komuna nuk posedon sistem monitorimi dhe nuk realizohet mbikëqyrje sistematike.

Në aspektin e monitorimit të dheut, komuna nuk ka sistem dhe nuk realizohet mbikëqyrje sistematike.

Sa i përket monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, komuna nuk ka sistem funksional dhe nuk disponon të dhëna për monitorim.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore.

Po ashtu nuk posedon kapacitete teknike dhe njerëzore të mjaftueshme për menaxhimin e të dhënave.

Kjo ndikon në mungesën e një sistemi të strukturuar për analizimin dhe përdorimin e të dhënave në vendimmarrje.

## **Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**

Bashkëpunimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel të mirë (4/5).

Një rast bashkëpunimi përfshin analizën mbi gjendjen e lumenjve, e cila është dërguar në nivel qendror pa kthim përgjigje.

Bashkëpunimi në hartimin e strategjive mjedisore vlerësohet gjithashtu 4/5, me pjesëmarrje në punëtori të organizuara nga GIZ.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare vlerësohet shumë i kënaqshëm (5/5).

Pjesëmarrja publike në proceset mjedisore mbetet e ulët (2/5).

Gjatë këtij viti, zyrtari për mbrojtjen e mjedisit ka marrë pjesë në seminare dhe takime të ndryshme të organizuara nga institucione vendore e ndërkombëtare <sup>4</sup>

Zyrtari për mbrojtjen e mjedisit ka marrë pjesë në punëtorinë “Climate Fresk”, e zhvilluar më 16 janar 2025. Kjo punëtori është organizuar nga Shoqata e Ndërgjegjësimit për Klimën (CAA), e mbështetur nga Helvetas Swiss Intercooperation, projekti DEMOS <sup>5</sup>

Po ashtu është marrë pjesë në punëtorinë për pajisjen e pjesëtarëve të komuniteteve me statusin e “Palë me interes”, e organizuar nga GIZ dhe SHPRK <sup>6</sup>

## **Licencimi dhe lejet mjedisore**

Licencimi dhe dhënia e lejeve për shfrytëzimin dhe menaxhimin e resurseve mjedisore nuk janë në kompetencë të plotë të nivelit komunal dhe realizohen nga institucionet e nivelit qendror.

Në nivel komunal lëshohen leje mjedisore për kategori të caktuara të aktiviteteve.

---

<sup>4</sup> Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar-Dhjetor 2025, linku: <https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/10.Raporti-i-punes-se-zyres-se-Kryetarit-dhe-drejtorateve-komunale-Janar-Dhjetor-2025.pdf>

<sup>5</sup> Po aty

<sup>6</sup> Po aty

Sipas legjislacionit në fuqi Lejet mjedisore komunale (LMK) lëshohen për një numër të caktuar të objekteve të kategorisë së II-të. Gjatë vitit 2025 janë trajtuar 68 kërkesa, ku prej tyre janë miratuar 47 kërkesa.<sup>7</sup>

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore komunale trajtohen aspektet si: identifikimi i ndikimeve në mjedis në tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerimi i mbeturinave dhe grumbullimi i tyre, zhurma, procesi teknologjik i punës, masat në raste të aksidentit, masat për rehabilitimin e sipërfaqes gjelbëruese, si dhe masat për efikasitetin e energjisë. Po ashtu caktohet lokacioni i kontejnerëve në situacion, sipërfaqja e gjelbërt, mbjellja dhe lokacionet e drunjëve<sup>8</sup>

Me qëllim që këto ndikime të kontrollohen, ndërsa ato negative të zvogëlohen në nivel të pranueshëm, synohet edhe rehabilitimi i hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projekteve të ndryshme<sup>9</sup>

---

<sup>7</sup> Po aty

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Po aty

## PËRFUNDIMET

Nga analiza e gjetjeve rezulton se Komuna e Lipjanit ka një strukturë institucionale funksionale për menaxhimin e çështjeve mjedisore, megjithatë me kapacitete të kufizuara njerëzore, ku evidentohet mungesë e stafit të dedikuar për këtë fushë .

Korniza ligjore mbi të cilën mbështetet komuna është pjesërisht e konsoliduar, ndërsa niveli i njohurive të stafit për këtë kornizë vlerësohet i mirë .

Në aspektin e planifikimit mjedisor, komuna nuk ka dokumente specifike të planifikimit, megjithëse aktivitetet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të integruara në aktivitetet komunale .

Sa i përket mbikëqyrjes inspektive, realizohen aktivitete të rregullta inspektimi dhe raportimi, duke përfshirë trajtimin e ankesave dhe kontrollin e zbatimit të lejeve mjedisore, ndërsa monitorimi i deponive dhe zonave të mbrojtura kryhet në mënyrë sistematike .

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, sasia e mbeturinave të grumbulluara mbetet pothuajse e njëjtë ndërmjet viteve 2023 dhe 2024, ndërsa evidentohet rënie e numrit të banorëve të shërbyer dhe rritje e gjenerimit të mbeturinave për banor, që lidhet me ndryshime në metodologjinë e raportimit .

Komuna nuk ka sistem funksional të monitorimit të ajrit, ujit dhe dheut, si dhe mungon një sistem i strukturuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore, për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike dhe njerëzore .

Bashkëpunimi me nivelin qendror dhe organizatat joqeveritare vlerësohet i mirë deri shumë i mirë, megjithatë pjesëmarrja publike në proceset mjedisore mbetet e ulët .

## REKOMANDIMET

1. Të rriten kapacitetet njerëzore në fushën e mjedisit, përmes angazhimit të stafit shtesë të dedikuar për menaxhimin mjedisor.
2. Të hartohen dhe miratohen dokumente specifike të planifikimit mjedisor, në mënyrë që të sigurohet një qasje më e strukturuar dhe strategjike në menaxhimin e mjedisit.
3. Të forcohet sistemi i menaxhimit të mbeturinave, duke përmirësuar mbulimin me shërbim dhe duke standardizuar metodologjinë e raportimit të të dhënave.
4. Të zhvillohet një sistem funksional për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë (ajri, uji dhe dheu), me qëllim sigurimin e të dhënave të besueshme për vendimmarrje.
5. Të krijohet dhe funksionalizohet një sistem i menaxhimit të të dhënave mjedisore, duke përfshirë përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore në këtë drejtim.
6. Të rritet niveli i pjesëmarrjes publike në proceset mjedisore, përmes organizimit të aktiviteteve informuese dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.
7. Të vazhdohet dhe të forcohet bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror dhe organizatat joqeveritare, me qëllim përmirësimin e menaxhimit mjedisor në nivel lokal.

## **Për EC:**

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

## **Deklarata e vizionit**

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

## **Deklarata e misionit**

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

# EC

MA NDARYSHE



[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)